



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-3945/13</u>
	Prot No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>18.11.2013</u>
Nr. pages	
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.11.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2775/13, për znj. Teuta Serhati – Kryeshefe e Departamentit Diagnostik të Spitalit “Isa Grezda” në Gjakovë, për arsye se e njëjta ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2775/13, për zyrtaren e lartë znj. Teuta Serhati – Kryeshefe e Departamentit Diagnostik të Spitalit “Isa Grezda” në Gjakovë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.T.SH. ORDINANCA SPECIALISTIKE FIZIATRIKE “TEUTA”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë rast, zyrtarja e lartë znj. Serhati është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e saj publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtarja në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ajo ka konfirmuar se ushtron pozitën e zyrtares së lartë si Kryeshefe e Departamentit Diagnostik në Spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë, dhe njëkohësisht është person i autorizuar në biznesin e lartpërmendur.

Pasi që ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, znj. Serhati ka premtuar se do të nisë menjëherë procedurat për shmangien e kësaj situate.

Ndërkohë, ajo ka dërguar në Agjenci një deklaratë, të protokoluar në Spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë (DPKI 03-3725/13) në të cilën vërtetohet se ka dhënë dorëheqje nga posti i Kryeshefes së Departamentit Diagnostik të këtij spitali.

Andaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

